

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Suhareka – Raporti komunal

Tetor 2009

## Suhareka në shifra

Popullsia	Gjithsej	75,075
	Shqiptarë	99.3%
	Ashkalinj	0.7%
Gjeografia	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	362
	Numri i fshatrave	43
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	19.95%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	46.07%
	E mesme	25.15%
	Shkollë e lartë	7.74%
	Universitet	1.09%
	Nr. i nxënësve	16505
	Nr. i mësimdhënësve	832
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	2
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	41
	Nr. i çerdheve	1
Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	11
	Nr. i mjekëve	38
Papunësia	Gjithsej	41.89%
	Meshkuj	38.94%
	Femra	51.43%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	45,796
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,320
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	8,061,331
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	1,040,000
	Të hyrat tjera (Euro)	7,021,331
Shpenzimet e realizuara (2008) <sup>1</sup>	Gjithsej (Euro)	6,745,171 (92%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	1,950,578 (79%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	4,794,593 (98%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	LDK	41.79%
	PDK	34.27%
	LDD	8.63%
	AAK	5.52%
	AKR	5.38%
	PD	1.22%
	Tjera	3.19%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Ukë Bytyqi (LDK) 2002-2007: Sali Asllanaj (LDK) 2007-2009: Sali Asllanaj (LDK)	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Suharekën

Suhareka është një nga pesë komunat përbërëse të regjionit të Prizrenit. Ka një popullsi prej rreth 75,000 banorësh dhe për nga numri i popullsisë radhitet e 11 në krahasim me komunat e tjera. Kurse për nga sipërfaqja territoriale, me 362 km<sup>2</sup> Suhareka radhitet e 14. Kjo komunë njihet si komunë bujqësore, ku më së shumti bujqit merren me prodhimtarinë e rrushit. Vreshtat janë edhe simbol i kësaj komune, pasi që fleta e rrushit është përfshirë edhe në stemën zyrtare të komunës. Një nga ndërmarrjet më të mëdha industriale është IGK "Ballkani".

## Problemet aktuale

Si në çdo komunë tjetër të Kosovës, edhe në Komunën e Suharekës edhe më tutje problem mbetet papunësia dhe varfëria. Konsiderohet se 41.89% e popullsisë së kësaj komune janë të papunë. Në Qendrën Komunale për Punësim janë të regjistruar 14,008 të papunë apo 18.6% e popullsisë së komunës. Kurse prej ndihmave sociale janë të varur 804 familje me 3,949 anëtarë (5.2% e popullsisë). Përveç këtyre problemeve, problemet tjera të komunës së Suharekës janë edhe:

- Furnizimi i pa mjaftueshëm me ujë të pijes;
- Ujërat e zeza;
- Komunikacioni në qytet;
- Mungesa e hapësirave të gjelbëruara dhe degradimi i tokës bujqësore.

**Mungesa e ujit të pijes.** Qytetarët e Komunës së Suharekës përballen me kufizime të mëdha sa i përket furnizimit me ujë të pijes, si ata që banojnë në qytet po ashtu edhe pjesët rurale të komunës. Ndodhë që qytetarët të mos kenë ujë të pijes deri në dhjetë orë në ditë apo më shumë. Problemi me ujë është problem me burime të ujit dhe me infrastrukturë për furnizim me ujë. Në qytet, lagjet që më së shumti përballen me këtë problem janë ato në rrugën e Reçanit (lagja e "Xhavit Sylës" dhe lagja e Berishëve). Fshatrat që më së shumti kanë problem me furnizim me ujë të pijes janë fshatrat Semetishtë, Studençan, Samadrexhë, Bukosh, Greikoc, Nepërbisht. Në fshatin Sopijë ekziston rrjeti i ujësjellësit, mirëpo banorët e këtij lokaliteti nuk kanë furnizim të mjaftueshëm me ujë. Situatën me furnizim me ujë e rëndojnë edhe gypat e vjetruar, kyçjet ilegale në ujësjellës, keqpërdorimi i ujit, rritja e numrit të popullsisë dhe menaxhimi jo i mirë nga kompania e ujësjellësit rajonal "Hidroregjioni-Jugor".

**Ujërat e zeza.** Përveç mungesës së rrjetit të ujësjellësit në këtë komunë mbetet edhe më tutje problem mungesa e kanalizimit të ujërave të zeza. Fshatrat Samadrexhë, Vraniç, Dobërdelan, Nepërbisht, Bukosh, Greikoc, etj., të gjitha i derdhen ujërat e zeza në shtratin e lumit që njihet si lumi i "Semetishtit". Edhe në qytet është evident problemi me ujërat e zeza. Kanalizimet derdhen në lumin Toplluha, lum i cili kalon përmes qytetit të Suharekës. Ky lum për shkak të papastërtisë kundërmon dhe rrezikon shëndetin e banorëve që kanë shtëpitë për skaj këtij lumi. Përveç ujërave të zeza, në Suharekë mund të gjenden edhe grumbuj të shumtë të deponive ilegale të bërrllokut. Mbeturinat hidhen edhe në shtratin e lumit Toplluha. Nuk ka kontejnerë nëpër fshatra dhe kompania rajonale për pastrimin e mbeturinave rrallëherë pastron deponitë e bërrllokut që gjenden jashtë qytetit.

**Komunikacioni.** Nëpër qendër të qytetit të Suharekës kalon rruga kryesore që lidh Prizrenin me pjesën tjetër të Kosovës. Si e tillë kjo rrugë është shumë e ngarkuar me

automjete. Për shkak të pozitës gjeografike, automjetet e rënda që lëvizin në drejtim të Prizrenit, shpesh kanë shkaktuar probleme në qytet të Suharekës. Për shkak të pozitës së pjerrët, gjatë lëshimit të automjeteve nga "Qafa e Dulës" u duhet që të mbajnë të shtypur vazhdimisht frenat. Si pasojë ndodhë që nga nxjerrja e frenave, këto automjete të rënda, që në të shumtën e rasteve janë të mbingarkuara me zhavorr apo mall ndërtimor, të humbin kontrollin kur të mbërrijnë në qendër të qytetit dhe të mos mund të frenojnë. Qytetarët e Suharekës përmendin shumë raste kur një gjë e tillë ka ndodhur dhe ka pasur edhe humbje të jetës së njerëzve, rasti i fundit ai i një 20 vjeçari që ka humbur jetën më 2008 nga një kamion që kishte dalë jashtë kontrollit. Vitin e kaluar Komuna e Suharekës kishte marrë vendim që asnjë automjet i rëndë që lëviz në drejtimin Prishtinë-Prizren të mos hyjë në qytet në periudhën kohore 6.00-20.00. mirëpo ky vendim nuk është jetësuar asnjëherë dhe këto mjete të rënda vazhdojnë që të qarkullojnë nëpër qytet. Qyteti nuk ka një qarkore rrugore nëpër të cilën do të mund të kalonin automjetet e rënda dhe të mos hynin në qytet.

**Mungesa e parqeve dhe degradimi i tokës bujqësore.** Në qendër të qytetit të Suharekës ndodhet një park i vogël, por i cili nuk është i përshtatshëm për qëndrim në te. Qytetarët shprehen se një park i mirëmbajtur dhe i gjerë do tu mundësonte atyre, si moshave të moshuara po ashtu edhe atyre më të reja, që të kalojnë kohën e lirë. Problem në këtë komunë mbetet edhe humbja e tokës bujqësore. Në mungesë të një zone industriale, shumë qytetarë bizneset e tyre i kanë ndërtuar në prona bujqësore duke bërë që ditë e më shumë të humbasin hapësirat e destinuara për bujqësi. Siç dihet komuna e Suharekës është e njohur edhe me mbjelljen e rrushit dhe kultivimin e tij.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Udhëheqja e komunës në këto tri mandate gjithnjë i ka takuar LDK-së. Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) si kryetar komune ka shërbyer Ukë Bytyqi. LDK fitoi shumicën e votave edhe në zgjedhjet e dyta lokale më 2002 dhe Ukë Bytyqi parashihej që të udhëhiqte sërish komunën edhe në mandatin e ardhshëm. Mirëpo, një ditë pas zgjedhjeve Ukë Bytyqi i vra nga një qytetar i kësaj komune. Sali Asllanaj mori postin e kryetarit të komunës dhe udhëhoqi me komunën deri në nëntor 2007. Në zgjedhjet e drejtpërdrejta për kryetar komune, Sali Asllanaj sërish fitoi të drejtën edhe për një mandat dy vjeçar. Sali Asllanaj (LDK) arriti të fitoj 9,470 vota apo 41.15% në raundin e parë dhe në zgjedhjet e balotazhit Sali Asllanaj arriti që të fitoj 10,983 vota apo 57.4% dhe në këtë mënyrë arriti që të fitoj në garën e ngushtë me Enver Hoxhajn nga PDK.

Gjatë fushatës zgjedhore 2007, Sali Asllanaj premtoi shtrim të rrugëve, shtrim të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit; investime në infrastrukturën shkollore, rregullimi i sheshit të qytetit, etj. Në të gjitha këto drejtime që është premtuar është bërë diçka, po në asnjërin nuk është bërë mjaftueshëm. Në të gjitha këto fusha ende ka probleme të shumta. Edhe më tutje problemi më i madh që i shqetëson qytetarët mbetet mungesa e ujit të pijes. Gjithashtu edhe ujërat e zeza shkaktojnë mjaft probleme në këtë komunë. Në tabelën 1 janë pasqyruar të gjitha premtimet e dhëna në debatet zgjedhore 2007 dhënë në emisionin "Jeta në Kosovë" dhe realizueshmëria e tyre dy vite më vonë.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi i premtimeve
Se do të investoj në shtrimin e rrugëve	Gjatë këtyre dy viteve, me mjete vetanake të komunës janë shtruar këto rrugë: rehabilitimi i rrugës Suharekë-Peqan; ndërtimi i rrugës "Hajdin Berisha"; ndërtimi i rrugës në fshatin Bukosh; asfaltimi i rrugës në fshatin Grejkoc; asfaltimi i rrugës "molla nura"; asfaltim i rrugëve tjera dhe shtrirja me zhavorr;
Se do të investoj në shtrimin e rrjetit të kanalizimit	Gjatë këtyre dy viteve komuna ka investuar në disa projekte të kanalizimit, siç janë: vazhdimi i kanalizimit në fshatin Dobërdolan; rregullimi i kanalizimit në fshatin Njëpërbisht; rregullimi i ujërave të zeza në Duhël.
Investime në rrjetit të ujësjellësit, sidomos rregullimi i ujësjellësit në lagjen "Xhavit Sylja"	Ka pasë disa investime në rrjetin e ujësjellësit, siç është rivitalizimi i ujësjellësit në fshatin Mushtisht, projekt i cili ende nuk ka përfunduar. Gjithashtu, një projekt që ende nuk ka filluar që të realizohet është edhe ai i ujësjellësit në fshatin Smadrexhë. Nuk është bërë asgjë në pëmirësimin me ujë të pijes në lagjen "Xhavit Sylja". Problemi i ujit edhe më tutje mbetet një nga problemet më madhore të kësaj komune.
Do të investoj në infrastrukturën shkollore	Janë bërë disa investime edhe në infrastrukturën shkollore, si me mjete vetanake komunale po ashtu edhe me mjete të MASHT. Me mjete të komunës është bërë ndërtimi i shkollës në fshatin Shirokë, është ndërtuar shkolla në fshatin Gelancë, me mjete të MASHT është ndërtuar shkolla në lagjen "Kuçi", është investuar në shkollën e mesme teknike "Skender Luarasi".
Do të investoj në rregullimin e sheshit të qytetit	Ky premtim është realizuar.
Do të rregulloj rrugën kryesore të qytetit duke e kubëzuar	Rruga kryesore e qytetit është kubëzuar gjatë vitit 2008. Përkundër përfundimit të punimeve, qytetarët ankohen se trotuari është ngritur shumë lartë. Arsyetimi i komunës është se ngritja e trotuareve është bërë për të pamundësuar parkingun e automjeteve në trotuar.

## Zgjedhjet lokale në Suharekë

Në Kuvendin Komunal të Suharekës mund të zënë ulëse 41 përfaqësues. Në tri legjislaturat e gjertanishme, nëntë parti politike kanë arrit që të përfaqësohen në KK në njërin nga legjislaturat, por vetëm tri parti politike janë përfaqësuar vazhdimisht. Shumicën e ulëseve në kuvendin 41 anëtarësh gjithnjë e ka fituar LDK. Në zgjedhjet e para lokale LDK fitoi 30 ulëse apo 19,475 vota; PDK fitoi 7 ulëse, AAK 2 dhe PQLK 2. Dy vite më vonë, LDK sërish fitoi shumicën e votave dhe ulëseve, por me një rënie të

lehtë edhe në vota edhe në përfaqësimin komunal. PDK në anën tjetër arriti të fitonte 3 vende më shumë, kurse AAK mbajti numrin e njëjtë të ulëseve por me një rënie në vota. Për herë të parë, në legjislaturën e dytë arritën të përfaqësoheshin edhe LPK me dy ulëse dhe PReK me një ulëse. Rënia e LDK vazhdoi edhe në zgjedhjet e treta lokale që u mbajtën më 17 nëntor 2007. Kësaj radhe LDK fitoi 18 ulëse, tetë më pak se pesë vite më parë dhe rreth 6,000 vota më pak. Ngritjen më të madhe e shënoi PDK e cila arriti të fitoj 14 ulëse. AAK për të tretën herë radhazi mban dy ulëse, edhe pse shënoi një ngritje prej 2,000 votave në krahasim me një vit më parë, por jo në atë masë sa kishte në zgjedhjet e para. Në legjislaturën e tretë për herë të parë u përfaqësuan edhe LDD, AKR dhe PD.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Suharekës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	4167	7	6272	10	7678	14
LDK	19475	30	15398	26	9362	18
AAK	1453	2	1028	2	1237	2
LDD	-	-	-	-	1933	4
AKR	-	-	-	-	1206	2
PD	-	-	-	-	274	1
PReK	-	-	505	1	-	-
LPK	-	-	1421	2	-	-
PQLK	1091	2	-	-	-	-

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme numri i votuesve ka shkuar duke rënë vazhdimisht. Në zgjedhjet e para lokale në vitin 2000 në vota dolën 28,093 qytetarë apo 86% të qytetarëve me të drejtë vote. Dy vite më vonë, 26,159 qytetarë dolën në votime (afro 2,000 më pak votues), kurse në anën tjetër numri i qytetarëve me të drejtë vote ishte rritur kështu që pjesëmarrja ra në 57.2%. Në zgjedhjet e treta lokale në votime dolën 22,404 qytetarë (mbi 4,000 votues më pak). Edhe pse nuk kemi arrit që të sigurojmë numrin e saktë të qytetarëve me të drejtë vote në zgjedhjet e nëntorit 2007, besohet se ky numër është rritur dukshëm për pesë vite dhe kjo ndikon që përqindja e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje të bie edhe më tutje. Në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009 të drejtë vote kanë 55,528 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Suharekë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
<b>Votues me të drejtë vote</b>	<b>32666</b>	<b>45681</b>	<b>?</b>
<b>Pjesëmarrja në votime</b>	<b>28093</b>	<b>26159</b>	<b>22404</b>
<b>Përqindja e daljes në votime</b>	<b>86.0%</b>	<b>57.26%</b>	<b>?%</b>

## Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Suharekës për vitin 2009 është 8,061,331 €. Ky është buxheti më i madh që Komuna e Suharekës ka pasur ndonjëherë. Në krahasim

me vitin 2008, buxheti i komunës për 2009 është rritur për afro 2 milion €. Buxheti i përgjithshëm ka shënuar rritje të vazhdueshme që nga viti 2003, me përjashtim të vitit 2007 kur ka shënuar rënie. Kategoria e cila në vazhdimësi ka shënuar ngritje nga viti në vit është ajo e rrogave dhe mëditjeve. 4,108,022 € janë të ndara për rrogat dhe mëditjet e 1320 punonjësve në sektorin publik komunal (administratë, arsim dhe shëndetësi).

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	4,108,022	785,568	195,000	110,000	2,862,741	8,061,331
2008	3,421,789	882,853	195,000	110,000	1,676,937	6,286,579
2007	3,273,651	852,226	185,000	100,000	1,336,325	5,747,202
2006	3,270,302	834,964	180,000	90,000	1,843,679	6,218,945
2005	3,213,860	784,230	189,200	70,000	1,640,460	5,897,750
2004	3,142,131	1,329,717	-	-	1,277,674	5,749,522
2003	2,618,568	1,520,300	-	-	607,616	4,756,484

Buxheti i përgjithshëm prej 6,286,579 € për vitin 2008, deri në fund të vitit është shpenzuar në masën 79%. Kurse buxheti për vitin 2009, në gjashtë mujorin e parë është shpenzuar në masën 36.6%. Sa i përket të hyrave vetanake, gjatë 2008 Komuna e Suharekës ka arrit që të arkëtoj 102.95% të mjeteve dhe kështu të tejkaloj parashikimet buxhetore që ishin bërë në fillim të vitit. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Suharekës për tri vitet në vazhdim do të jetë 28,922,001 €.

## Investimet kapitale

Për investime kapitale, nga buxheti i përgjithshëm i Komunës së Suharekës këtë vit janë të ndara 2,862,741 €. Kjo shifër është për 1,2 milion më e lartë se sa një vit më parë. Në këto dy vitet e fundit për investime kapitale kanë qenë në dispozicion 4,539,678 €. Nga këto mjete janë kryer një mori projektesh, disa prej të cilave i kemi paraqitur në tabelën 5.

Tab.5.: Investimet kapitale në Suharekë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Rregullimi i rrugës Suharekë-Peqan	€268,410
2008	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Shirokë	€150,000
2008	Ndërtimi i rrugës "Hajdin Berisha"	€139,090
2008	Ndërtimi i shkollës së mesme teknike në fshatin Suharë	€206,500
2009	Ndërtimi i rrugës Skenderbeu (faza e II-të)	€200,000
2009	Ndërtimi i rrugës magjistrale në lagjen e Sopajve	€100,000
2009	Riparimi i rrugës "Brigada 123"	€294,570

Deri në fund të vitit 2008, buxheti i destinuar për investime kapitale ka arritur të shpenzohet në masën 79%. Kurse në periudhën janar-qershor 2009, buxheti për investime kapitale është shpenzuar në masën 23.1%

Kuvendi Komunal i Suharekës ka miratuar edhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2010-2012. Në bazë të kësaj kornize, parashihet që buxheti për investime në tri vitet e ardhshme të kap shumën prej 12,618,000 €.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Suharekës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	9,347,211	9,615,876	9,958,914
Të hyrat vetanake në €	1,489,433	1,536,717	1,581,045
Investimet kapitale në €	3,920,000	4,183,000	4,515,000

Nëse mund të japim një vlerësim edhe për vitin 2013 duke u bazuar në këtë kornizë të shpenzimeve, mund të përfundojmë se Kryetari i ardhshëm i komunës së Suharekës për mandatin e tij katër vjeçar do të ketë në dispozicion 17.1 milion euro për investime kapitale.

## Administrata komunale

Në sektorin publik komunal (administratë, arsim dhe shëndetësi) në vitin 2009 janë të punësuar 1320 veta. Ky numër është më i madh se sa një vit më parë. Në administratën komunale janë të punësuar 147 punonjës. Sipas një vendimi të Qeverisë së Kosovës (vendimi 10/46 i 3 dhjetorit 2008), komunat me më pak se 100,000 banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 620 banorë. Sipas kësaj formule del se Komuna e Suharekës ka staf të tepërt punonjësish, ngase numri maksimal i lejuar është 134. Ky numër është parë si i arsyeshëm me qëllim që administrata të jetë mbuluar me staf të nevojshëm në çdo sektorë.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Suharekës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1320 ▲
2008	1302 ▲
2007	1289
2006	1332 ▲
2005	1328
2004	1333 ▲
2003	1251 ■

## Komuna e Suharekës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton pragjet minimale të aktiviteteve të komunave gjatë një viti. Kuvendet Komunale janë të obliguara që brenda vitit të mbajnë së paku dhjetë mbledhje të rregullta, të formojnë komitete konsultative; kryetari i komunës



duhet që së paku të mbaj dy tubime publike me qytetarë, njërin prej tyre në pjesën e parë të vitit, etj.

Kuvendi Komunal i Suharekës ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta gjatë 2008 dhe gjashtë mbledhje të rregullta janë mbajtur gjatë periudhës janar-qershor 2009. Deri më tani KK i Suharekës ka miratuar pesë rregullore komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), si komiteti më i rëndësishëm i Kuvendit Komunal, gjatë 2008 ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta, kurse për periudhën janar-qershor 2009 ka mbajtur shtatë mbledhje. Gjatë 2008 në komunën e Suharekës janë parashtruar shtatë kërkesa për qasje në dokumente zyrtare dhe një peticion. Kurse për periudhën janar-qershor 2009 nuk është parashtruar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare apo peticion.

Komuna e Suharekës ka edhe uebfaqen e saj zyrtare, mirëpo e cila ka shumë zbrazëtira sa i përket përmbajtjes së informacioneve. Tabela më poshtë tregon që në ueb faqen e KK Suharekë ka zbrazëti të konsiderueshme në lidhje me shërbimet dhe projektet komunale si dhe mungojnë informacione lidhur me informatat bazë për qytetin.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Suharekës ([www.suhareka-komuna.org](http://www.suhareka-komuna.org))

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>2</sup>
Ballina	4
Organizimi komunal	2.33
Shërbimet komunale	2.6
Info rreth qytetit	1
Projektet komunale	2.25
Lajme & lajmërim	3.67
Harta e faqes	2
Kontakt	5
Gjuhët	4
Fusha për kërkim	4
Tjera informacione shtesë	3
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	3.15
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	11

## Gjendja në arsim

Në komunën e Suharekës sistemi arsimor është i organizuar nga ai parafillor e deri te arsimi i mesëm i lartë. Në këtë komunë ekziston një çerdhe, 41 shkolla fillore (23 shkolla amë dhe 18 paralele), dhe 2 shkolla të mesme. Çerdhja e vetme publike nuk i plotëson nevojat e këtij qyteti. Në infrastrukturën shkollore janë bërë disa investime në këto dy vite si me mjete të MASHT, po ashtu edhe me mjete vetanake të komunës.

<sup>2</sup> Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Me mjete të komunës është bërë ndërtimi i shkollës në fshatin Shirokë, është ndërtuar shkolla në fshatin Gelancë, me mjete të MASHT është ndërtuar shkolla në lagjen “Kuçi”, është investuar në shkollën e mesme teknike “Skender Luarasi”.

Hapësira shkollore në këtë komunë është relativisht e mirë, me përjashtim të shkollave të mesme ku ka nevojë për zgjerim të hapësirës shkollore. Përveç infrastrukturës, problem mbetet kualiteti i mësimdhënies dhe disiplina në shkollë. Komuna përballlet me vështirësi në sigurimin e kuadrit të kualifikuar, sidomos për lëndët e anglishtes, artit dhe matematikës. Rekrutimet e stafit arsimor për çdo vit janë burim i kritikave mes pozitës dhe opozitës duke u hedhur akuza për politizim të stafit arsimor.

## Gjendja në shëndetësi

Institucioni më i lartë shëndetësor në komunën e Suharekës është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. Përveç QKMF-së, në këtë komunë funksionojnë edhe 6 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 5 punkte shëndetësore. Në QKMF ofrohen shërbimet e mjekësisë familjare, pediatrikë, gjinekologjisë, urgjencës, rëntgenit, analizat biokimike, stomatologjisë, etj. Tani së fundmi funksionon edhe emergjenca. Përveç institucioneve publike, në këtë komunë punojnë edhe 27 institucione shëndetësore private.

Ashtu si edhe në komunat e tjera të Kosovës, problem në shëndetësinë primare të Suharekës edhe më tutje mbetet furnizimi i rregullt me barna nga lista esenciale. Për rastet më të rënda shëndetësore, qytetarët e Suharekës detyrohen që të drejtohen në spitalin regjional në Prizren.

## Shoqëria civile

Në komunën e Suharekës janë aktive disa organizata jo qeveritare. Fokusi kryesor i shumicës së organizatave aktive në këtë komunë është fuqizimi i gruas, aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore. Organizatat jo qeveritare nuk kanë shfaqur ndonjë interesim për monitorim të punës së organeve komunale apo formulim të kërkesave të qytetarëve në drejtim të komunës. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), zyra në Prizren, herë pas here monitoron punën e Kuvendit Komunal të Suharekës.

## Mediat lokale

Si media lokale në komunën e Suharekës janë të regjistruara dy radio: Radio 2000 dhe Radio Suhareka. Këto dy medime janë aktive me programe argëtuese, dhe në një masë edhe me programe informative. Radio 2000 bën monitorimin e punës së organeve komunale dhe transmeton informacione rreth aktiviteteve të përfaqësuesve lokal. Në këtë komunë përcillen në masë të madhe edhe televizionet nga Prizreni, si TV Opinion dhe TV Prizreni. Seancat e KK të Suharekës transmetohen edhe përmes këtyre televizioneve. Gjithashtu, televizionet e Prizrenit transmetojnë edhe kronika me temë nga komuna e Suharekës. Edhe gazetatat ditore kanë korrespondentët e tyre lokal në këtë komunë të cilët janë aktiv me shkrime rreth aktiviteteve komunale.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Suharekës

Suhareka është një komunë relativisht e qetë. Nëse marrim për bazë se sipas numrit të popullsisë Suhareka radhitet e 11 në Kosovë, për nga numri i rasteve të shkeljes së rendit dhe ligjit gjatë një viti kjo komunë radhitet e 18. Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Suharekës kanë ndodhur 868 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 54 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Suharekë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve
Aksidente	196
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	55
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	25
Vjedhje e pyjeve	8
Incidente lidhur me pronën	71
Vjedhje	195
Abuzime seksuale	3
Shkaktim të dëmtimeve trupore	80
Kërcënime	54
Mashtrime	10
Vrasje	3
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimore të tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i Suharekës ka miratuar edhe Rregulloren e tatimit në pronë. Sipas kësaj rregulloreje, komuna e Suharekës ndahet në katër zona dhe normat tatimore sillen nga 0.15% deri në 0.20%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Suharekës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	<b>Norma tatimore</b>				
	0.15%	0.15%	0.20%	0.20%	0.15%
I	450€	400€	1,000€	200€	75€

II	-	350€	650€	180€	75€
III	-	300€	500€	150€	75€
IV	-	250€	350€	130€	75€

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Në komunën e Suharekës funksionojnë rreth 1,700 subjekte afariste private. Së paku aq janë të regjistruara si biznese në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, por një numër i madh i tyre mund edhe të mos jenë aktive. Prej këtyre bizneseve, 47% ushtrojnë veprimtari tregtare; 13% janë kompani ndërtimore; 12% janë kompani transportuese, kurse 7% janë veprimtari shërbyese. Të gjitha këto biznese duhet që të marrin lejen e punës nga Komuna e Suharekës. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, në tabelën 11 kemi përshkruar disa nga bizneset më të zakonshme që mund të hasen në këtë komunë dhe çmimi që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	800 – 1,000 €
Kompanitë e sigurimit	800 – 1,000 €
KEK	800 – 1,000 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	800 – 1,000 €
Barnatoret	350 €
Agjensionet turistike	200 €
Hotelet	700 €
Motelet	500 €
Supermarketet-Hipermarketet	500 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	300 €
Kafeteritë	200 - 250 €
Restorant	250 - 500 €
Telekomunikimet	100 - 150 €
Gurthyesit	350 €
Shitja e mekanizmave bujqësore	350 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthëtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50 - 100 €
Depot	300 €
Pompat e benzinës	700 €
Ndërmarrjet ndërtimore	350 - 500 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	250 - 400 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, [ëëë.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.